

KARTËMONËDHA 200 LEKË KARTËMONËDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

PSE NJË SERI E RE?

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë besimin e publikut te paraaja kombëtare. Ajo e bën këtë duke emetuar një kartëmonedhë që i komunikon publikut shqiptar, siguri dhe qëndrueshmëri.

20 vjet pas hedhjes për herë të parë në qarkullim të serisë aktuale të kartëmonedhave Lek, natyrshëm ka lindur nevoja për përmirësim me elemente të reja, për t'i bërë ato më të sigurta ndaj falsifikimit. Kartëmonedhat tona shërbejnë edhe si mbartëse të elementeve të identitetit kombëtar. Përmes mjeshtërisë artistike, ato promovojnë historinë e Shqipërisë dhe theksojnë kontributet e personaliteteve të saj.

Për këto arsye, Banka e Shqipërisë ka emetuar një seri të re të kartëmonedhave Lek, me pamje të rifreskuar dhe elemente sigurie të përmirësuara. Kjo seri është prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës, ndërkohë që edhe pamja e kartëmonedhave do të jetë më moderne.

PREZANTIMI GRADUAL I SERISË

Seria e re e kartëmonedhave do të hidhet në qarkullim gradualisht, duke filluar me prerjet 200 dhe 5000 Lekë në vitin 2019, ndërsa gjatë viteve 2020-2022 do të vijojë hedhja në qarkullim e prerjeve të tjera.

Kartëmonedhat ekzistuese do të vazhdojnë të qarkullojnë dhe të kenë kurs ligjor si mjet pagese, së bashku me kartëmonedhat e reja.

KËSHILLA PËR PËRDORIMIN E KARTËMONEDHAVE

Kartëmonedha përbën një vlerë kombëtare.

Trajtoje kartëmonedhën ashtu siç është: më shumë se një letër me vlerë. Përveçse mbart vlerën nominale, ajo paraqet një ndërthurje të vlerave artistike me elemente të identitetit kombëtar.

Ruaje kartëmonedhën në portofol

Mos e dëmto duke e rrudhosur, përthyer, shkruar, ngjyrosur, prerë ose ngjitur atë. Kështu, ti ndihmon që ajo të qëndrojë në qarkullim, sa më gjatë.

DHE MOS HARRO!!!

Lexo dhe përdor shifrën që shkruhet mbi kartëmonedhë! Mos i shto një 0! Mos e quaj as të vjetër, as të ri! Ai quhet thjesht LEK. Kërkoju edhe të tjerëve ta respektojnë atë, njësoj si ti.

Për më shumë informacion vizito www.bankofalbania.org



*Të Shqipëri
më jep nder,
më jep emrin Shqiptar*



2017

ELEMENTET E SIGURISË

Kontrollo nëse kartëmonedha është e vërtetë, përmes verifikimit të elementeve të sigurisë me metodën "PREK, SHIKO, LËVIZ".

PREK

Preke dhe ndieje kartëmonedhën me gjishta.

Kjo kartëmonedhë është prodhuar prej materiali polimer, një përbërje plastike, që të jep një ndjesi të veçantë në prekje.

- 1 Shtypi i ngritur:** Ndieje shtypin e ngritur të numrat, shkronjat, portreti, si dhe vijat e shkurtra përgjatë skajit të majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë dhe elementin e njohjes së kartëmonedhës nga të verbrit.

SHIKO

Mbaje kartëmonedhën kundrejt dritës dhe shikoje me kujdes.

- 2 Dritarja:** Në një dritare të tejdukshme shfaqet portreti i Naim Frashërit, vlera 200 Lekë dhe kolonada e ndërtesës së Bankës së Shqipërisë.
- 3 Elementi i regjistrimit:** Një figurë e stilizuar e shqiponjës ndodhet në të dy anët e kartëmonedhës. Të dy figurat duhet të përkojnë ekzakhtësisht njëra me tjetrën.

LËVIZ

Lëvize kartëmonedhën në kënde të ndryshme shikimi, për të parë si ndryshon.

- 4 Shiriti i shndritshëm në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 200 Lekë.**

